



UNIVERSITETI
SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 757/20; Datë: 02.03.2020

Në bazë të nenit 1 pika 2 të Rregullave dhe Procedurave për Zgjedhjet e Përgjithshme në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) dhe nenit 10, pika 1 të Rregullores për Zgjedhjet Studentore në UShAF, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 02.03.2020, merr

V E N D I M

- I. Shpallen zgjedhjet studentore në UShAF, të cilat do të mbahen me 20.03.2020.**
1. Komisioni Qendror Zgjedhor do të konstituohet një ditë pas datës së shpalljes së zgjedhjeve.
 2. Të gjitha organizatat studentore të cilat marrin pjesë në zgjedhje, duhet të jenë të regjistruara në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike dhe të certifikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
 3. Zgjedhjet studentore do të mbahen në pajtim me Rregulloren për zgjedhjet studentore në UShAF dhe sipas Dinamikës së miratuar nga Këshilli Drejtues.
- II. Shpallen zgjedhjet e përgjithshme në UShAF të cilat do të mbahen me 09.03.2020.**
1. Zgjedhjet e përgjithshme mbahen për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Mësimor/Shkencor, drejtorëve të programeve të studimit, përfaqësuesëve të përkohshëm të drejtorëve të programeve të studimit dhe anëtarëve të Senatit.
 2. Zgjedhjet e përgjithshme do të mbahen në pajtim me Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme në UShAF, Rregullores për Zgjedhjet në UShAF dhe punën e Këshillit Mësimor/Shkencor dhe sipas Dinamikës së miratuar nga Këshilli Drejtues.
- III. Vendimi hynë në fuqi nga dita e marrjes së tij.**

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Drejtues të UShAF;
2. Arkivit

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. As. Dr. Samet DALIPI